



Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/219 Nr. i faq./Br.str./No.pg 65

Data/Datum/Date 29/04/2024

Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe pika 2 shkronja d), nenit 17 shkronja (h) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 5 të Ligjit Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, nenit 6 të Udhëzimit Administrativ (MASH) Nr. 151/2020 për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Drejtorit dhe të Zëvendës Drejtorit të Institucionit Publik Edukativo-Arsimor dhe Aftësues Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Procedurat e Zgjedhjes dhe Emërimit, Përfundimit të Kontratës dhe Emërimit të Përkohshëm, nenit 2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.11, nenit 57 paragrafi 1 pika 1.8 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, propozimit të Drejtorisë për Arsim në Komunën e Rahovecit me Nr. Reference 04/1659 të dt. 05.03.2024, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me dt. 29.04.2024 miraton këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për përzgjedhjen e drejtorit/es dhe zëvendës drejtorit/eshës së institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese parauniversitare (IEAAP)

1. **Caktohet** komisioni për përzgjedhjen e drejtorit/es dhe zëvendës drejtorit/eshës së institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese parauniversitare (IEAAP) në Komunën e Rahovecit që kanë konkuruar në konkursin e shpallur nga Drejtoria për Arsim, në këtë përbërje:

- 1.1. Lulzim Krasniqi, Udhëheqës i Sektorit për Arsim, pranë Drejtorisë për Arsim, kryesues
- 1.2. Vjollca Vuçitërna, Drejtoreshë në IAAAP “Selajdin Mullabazi – Mici” në Rahovec, anëtare
- 1.3. Anëtar i tretë vjen nga MASH-i sipas UA Nr. 151/2020 i dt. 22.12.2020

2. Detyra e komisionit është intervistimi i kandidatëve që kanë konkuruar në konkursin e cekur në pikën 1 të këtij vendimi dhe në bazë të pikëve të fituara, bën ranglistën e kandidatëve dhe i rekomandojnë Kryetarit të Komunës emërim të kandidatëve më të suksesshëm për drejtor/eshë apo zëvendës drejtor/eshë e shkollës sipas konkursit.
3. Obligohet komisioni përzgjedhës që punët të kryej duke u bazuar në liget dhe aktet nënligjore në fuqi në Republikën e Kosovës.
4. Mandati i komisionit përzgjedhës të cekur në pikën 1 të këtij vendimi është 1 (një) vit.
5. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Shërbimit të Kuvendit,
- Drejtorisë për Arsim,
- MAPL-së, dhe
- Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01Nr.219/24
Datë:29.04.2024

Arbër Zenuni
Kryesues i Kuvendit